



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.65, datë 21.03.2023

PËR
“CAKTIM TË PËRKOHSHËM”

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 59 pika 1 dhe 4, të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, Rregulloren “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve” e ndryshuar, si dhe relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Zoti Neritan Hoxha, aktualisht prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec, caktohet përkohësisht të ushtrojë funksionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec.
2. Zoti Neritan Hoxha do të ushtrojë funksionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec, nga data 31.03.2023 deri më 30.04.2023.
3. Për periudhën e përmendur në pikën 2, zoti Neritan Hoxha do të paguhet me pagën e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec.
4. Të njoftohen për këtë vendim zoti Neritan Hoxha, Prokurori i Përgjithshëm dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
6. U shpall në Tiranë, sot më 21.03.2023.

KRYËTAR
Alfred Balla

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Elaida Coxhi

ANËTAR
Mirela Bogdani

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

ANËTAR
Bujar Sheshi

ANËTAR
Esmeralda Keshi

ANËTAR
Arta Mandro

ZV/KRYËTAR
Tamar Bazaj

ANËTAR
Nurihan Seifi

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Ledina Riza